

Projekti i infrastrukturës dhe i nxitjes së turizmit në Shqipëri

Duration: 01.12.2020 - 31.12.2027

Countries:
Albania

EU contribution: € 40 000 000

Total budget: € 105 000 000

Implementer:

European Bank for Reconstruction and Development (EBRD)

Website(s): euprojects.al/euprojects/tourism-led-model-for-local-economic-development-support-programme-2/

Project description

Projekti i infrastrukturës dhe i nxitjes së turizmit në Shqipëri (AIP) është një program i përbashkët BE-BERZH (Bashkimi Evropian – Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim), që mbështet zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të Shqipërisë të udhëhequr nga turizmi. Ai ndërthur financimin e BERZH-it dhe grantet e BE-së për të përmirësuar cilësinë, qëndrueshmërinë dhe konkurrueshmërinë e sektorit turistik të Shqipërisë, duke:

- zhvilluar produkte dhe destinacione turistike;
- restauruar dhe përmirësuar asetet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore;
- përmirësuar infrastrukturën bashkiake dhe transportuese;
- rritur aftësitë dhe;
- zgjeruar aksesin në financim për NVM-të (Ndërrmarrjet e vogla dhe të mesme).

Programi fokusohet në bashkitë pilote të Beratit, Fierit, Korçës dhe Shkodrës. Ai zbatohet përmes katër dritareve të ndërhyrjes:

- Dritarja 1 – Asistencë teknike me fokus te turizmi, që përfshin zhvillimin e destinacioneve, krijimin e produkteve turistike, shërbimeve këshillimore për NVM-të, zhvillimin e aftësive dhe përfshirjen gjinore dhe ekonomike.
- Dritarja 2 – Rehabilitimi i siteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, që përfshin financimin e restaurimit, ruajtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të aseteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Expected results:

- Rritja e kohëzgjatjes mesatare të qëndrimit dhe e numrit të vizitorëve në destinacionet pilote të Beratit, Fierit, Korçës dhe Shkodrës;
- Trajnimi dhe zhvillimi i aftësive të të paktën 2,000 pjesëmarrësve të sektorit të turizmit dhe i më shumë se 200 ekspertëve nga institucionet publike dhe site të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, me gratë që përbëjnë të paktën gjysmën e të gjithë përfituesve;
- Restaurimi dhe përmirësimi i 24 aseteve të trashëgimisë kulturore, natyrore dhe i infrastrukturës së lidhur me turizmin;
- Mobilizimi i financimit të BERZH-it përmes institucioneve financiare pjesëmarrëse, për të zgjeruar aksesin në financim dhe për të forcuar konkurrueshmërinë e NVM-ve të lidhura me turizmin.

